



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE
SIGURISË PUBLIKE

Nr. 1087/1 prot.

Tiranë, më 04.04.2025

Lënda: Mbi ribashkërendimin e projektligjit “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë”

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj nr. 5258/19 prot., datë 26.03.2025, protokolluar me tonën me nr. 1087 prot., datë 01.04.2025, me anë të së cilës dërgoni sërish për bashkërendim projektligjin “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë” (në vijim, “projektligji”), si dhe relacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i projektligjit të ridërguar, Zyra e Komisionerit vlerëson marrjen në konsideratë të sugjerimeve të dhëna nga ana jonë, me shkresën nr. 738/1 prot., datë 27.02.2025. Megjithatë, me qëllim që ky projektligj të jetë në të njëjtën linjë me legjislacionin në fuqi të mbrojtjes së të dhënave personale, vlerësojmë nevojën e disa saktësimeve, të cilat i ridërgojmë, si më poshtë vijon:

Në pikën 14, të nenit 3 të projektligjit, citohet se: “Përdorimi i të dhënave është shpërndarja dhe shkëmbimi kombëtar apo ndërkombëtar i të dhënave të pasagjerit...”.

Ju bëjmë me dije se, përdorimi është një nga veprimet që kryhet me të dhënat personale, e si i tillë, konsiderohet përpunim, në kuptim të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim, “Ligji nr. 124/2024”).

Për më tepër, në pikën 16, të nenit 5 të Ligjit nr. 124/2024, si dhe në pikën 13, të nenit 3 të projektligjit¹, janë përcaktuar qartazi veprimet dhe proceset përpunuese të konsideruara

¹ “Përpunim” është çdo veprim ose një grup veprimesh, që kryhet mbi të dhënat personale ose grupe të dhënash personale, pavarësisht nëse kryhen me mjete të automatizuara ose jo, të tilla, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, **përdorimi**, përhapja me anë të transmetimit, shpërndarjes ose vënies në dispozicion në ndonjë mënyrë tjetër, lidhja ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose shkatërrimi”.

si përpunim i të dhënave personale, ku ndër të tjera, specifikohet se, sikurse *përdorimi*, edhe proceset e tjera, të cilave u referoheni si përdorim i të dhënave (shpërndarja, shkëmbimi apo transferimi kombëtar e ndërkombëtar), janë procese përpunuese më vete.

Në mbështetje të legjislacionit kombëtar e ndërkombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale, tërësia e këtyre veprimeve, vlerësohet si përpunim i të dhënave personale.

Duke qenë se, “*përdorimi i të dhënave*”, përfshihet tashmë në përkufizimin e përpunimit të të dhënave personale, në dispozitat e sipërcituara, sugjerojmë që, **pika 14, e nenit 3 të mos përfshihet në projektligj**, për të ruajtur qartësinë dhe për të shmangur çdo përsëritje të panevojshme.

Si rrjedhojë, sugjerojmë që, **titulli i nenit 17 të projektligjit**, të riformulohet më përmbytje: “*Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale*”.

Gjithashtu, referuar **pikës 21, të nenit 3 të projektligjit**, sugjerojmë që, të riformulohet me përmbytje, si vijon: “*”E dhënë personale” ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në pikën 3, të nenit 5 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”*”.

Në vijim, **në pikën 2/b, të nenit 4 të projektligjit**, sugjerojmë zëvendësimin e fjalës “*përpunim*”, me një nga proceset përpunuese të të dhënave personale, të specifikuara në pikën 13, të nenit 3 të projektligjit.

Sa më sipër, vlerësojmë se, përdorimi i kësaj terminologjie duhet t’i referohet parashikimeve të Ligjit nr. 124/2024 dhe direktivave të Bashkimit Evropian, mbi të cilat synohet ky përafrim, për të siguruar saktësinë dhe konsistencën, gjatë zbatimit të aktit ligjor në praktikë.

Nga shqyrtimi i relacionit shoqërues të projektligjit, bëni me dije se “*referuar Ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, emërtimi korrekt është punonjës policie dhe jo nëpunës policie*”.

Zyra e Komisionerit sqaron se, punonjësi i policisë, i ngarkuar me detyrat që burojnë nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale, emërtohet “nëpunës i mbrojtjes së të dhënave personale”, në mbështetje të neneve 33 dhe 34 të Ligjit nr. 124/2024. Caktimi i nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave personale është një detyrim i rëndësishëm për t’u zbatuar nga të gjithë Kontrolluesit, sikurse janë edhe strukturat e Policisë së Shtetit, pa ndikuar në detyrat e tyre funksionale, të cilat burojnë nga Ligji nr. 82/2024 “*Për Policinë e Shtetit*”.

Për këtë arsye, në mënyrë që të unifikohet terminologjia e përdorur në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, sugjerojmë që, në projektligj, togfjalëshi “*punonjës i mbrojtjes së të dhënave personale*” të zëvendësohet me fjalën “*nëpunës i mbrojtjes së të dhënave personale*”.

Sa më sipër, me reflektimin e propozimeve të sipërpërmendura, projektligji vlerësohet i hartuar në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi